



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

V E N D I M

Nr. 125, Datë 05/07/2021

Mbështetur nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në referencë të informacionit të dërguar me e-mail në datën 13.04.2021, nga Shoqatat Aleanca LGBTI dhe Pro LGBT Albania, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat për shqyrtimin kryesisht të çështjes, në lidhje me refuzimin e shërbimit taksi ndaj disa personave transgjnorë, në datën 26.03.2021, nga ana e Shoqërisë “Green Taxi”.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Sipas informacionit të administruar, rezulton se Shoqata Pro LGBT ka dalë me një publikim në rrjetin social Facebook, në datën 13.04.2021, lidhur rastin e refuzimit të shërbimit taksi ndaj disa personave transgjnorë, në datën 26.03.2021, nga ana e Shoqërisë “Green Taxi”. Në këtë publikim citohet: “Më datë 26.03.2021, rreth orës 16:45, kompania e shërbimit taxi “GreenTaxi”, përmes një akti të paprecedentë, refuzoi shërbimin ndaj personave transgjnorë në Tiranë, ku punonjësja e centralit pasi u pyet se përse nuk u ofrua shërbimi nga kompania që përfaqëson, u shpreh: “Asnjë nga shoferët nuk e merr. Nuk konceptojnë dot të fusin në makinë persona që janë tranvestitë.” Aleanca Lgbt dhe PRO LGBT, pas ngjarjes së fundit kërkojnë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

marrjen e masave nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj kompanisë GreenTaxi. Individët transgjnorë janë qytetarë që në bazë të ligjeve në fuqi dhe garancive themelore të çdo shteti demokratik, meritojnë të gëzojnë efektivisht të drejta të barabarta, pa dallim nga pjesa tjetër e shoqërisë. Aleanca LGBT dhe PRO LGBT, pas ngjarjes së fundit kërkojnë marrjen e masave nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj kompanisë Green Taxi. Individët transgjnorë janë qytetarë që në bazë të ligjeve në fuqi dhe garancive themelore të çdo shteti demokratik, meritojnë të gëzojnë efektivisht të drejta të barabarta, pa dallim nga pjesa tjetër e shoqërisë.”

Sipas informacionit të sipërcituar, sikurse referuar edhe audios së regjistruar së bisedës telefonike me operatoren e shërbimit të kompanisë², rezulton se në datën 26.03.2021, rreth orës 16:45, Shoqëria “Green Taxi” ka refuzuar t’u ofrojë shërbimin me taksi disa personave transgjnorë në Tiranë. Mbështetur në informacionin e dy shoqatave të sipërcituara rezulton se, operatorja e shërbimit telefonik të Green Taxi, pasi është pyetur mbi arsyet e këtij refuzimi, është përgjigjur se shoferët e shoqërisë refuzojnë t’i marrin në taksi personat tranvestitë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim çështjen e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

² Për më shume informacion lutem referojuni <https://www.historiaime.al/ndodhi-sot/reagim-kunder-kompanise-greentaxi/>

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Hapat procedural të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të fakteve të administruara, në referencë të nenit 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, informacioni u cilësua i besueshëm. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e çështjes kryesisht nëpërmjet Urdhërit nr.47, date 13.04.2021.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 626/1, datë 15.04.2021, shoqërisë “Green Taxi” dhe për dijeni Shoqatave pro LGBT dhe Aleanca LGBTI, ku kërkohej informacion mbi ngjarjen e ndodhur në datën 26.03.2021, si vijon:

1. Informacion i përgjithshëm mbi rastin konkret;
 2. Informacion nëse Shoqëria Green Taxi e ndalon ofrimin e shërbimit ndaj personave transgjnorë;
 3. Informacion mbi faktin nëse Shoqëria “Green Taxi” ka ndjekur edhe më parë praktika të tilla, lidhur me refuzimin e shërbimit taksi ndaj personave, për shkak të identitetit gjinor;
 4. Informacion nëse pranë shoqërisë “Green Taxi” është depozituar ankesë me shkrim nga Shoqatat Aleanca LGBTI dhe Pro LGBT Albania, apo nga personat, të cilëve u është refuzuar shërbimi;
- Shoqëria Green Taxi nuk i ktheu përgjigje shkresës së Komisionerit.
 - Në vijim, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se Shoqëria Green Taxi kishte kërkuar falje publike për incidentin e ndodhur, në datën 26.03.2021, fakt që ishte reflektuar në artikujt e publikuar në datën 14.04.2021, në median online, përkatësisht në www.dylbersizem.com dhe në www.historiaime.al.
 - Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri iu drejtuar sërish Shoqërisë Green Taxi nëpërmjet shkresës nr.626/2, datë 21.05.2021, ku i bën kujtesë për kthim përgjigje dhe dërgim informacion brenda datës 24.05.2021.
 - Në përgjigje të shkresave të KMD-së, Shoqëria Green Taxi dërgoi shkresën nr. 626/3, datë 25.05.2021, ku sqaron se: *“Duke marrë shkas nga indinjata që ka krijuar publikimi i një bisede telefonike midis një punonjëse të Green Taxi dhe një klienti, ne si kompani e ndjejmë të domosdoshme të qartësojmë se qendrimi i operatores së përfshirë në këtë incident nuk është absolutisht qendrim përfaqësues dhe i rregullores së kompanisë. Që prej krijimit, Green Taxi ka synuar rritjen e standardit të shërbimit për klientët, të cilët në sytë tanë janë njëlloj të çmuar pa asnjë dallim. Gjithashtu bëjmë me dije për publikun se për personelin e përfshirë janë marrë masa disiplinore.”*

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, të ndryshuar, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 626/4, datë 14.06.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 24.06.2021, ora 10:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesja e shoqërisë “Green Taxi” dhe znj. Xh. K., përfaqësuese e Shoqatës Aleanca LGBTI me përfaqësuesen ligjore të kësaj shoqate.

Në këtë seancë, nga ana përfaqësuesve të Shoqatës Aleanca LGBTI u parashtrua edhe një herë informacioni i dhënë para Komisionerit. Këta përfaqësues vunë në dukje faktin se herën e parë, shoqëria Green Taxi e kishte ofruar shërbimin ndaj një individi transgjinator, duke e transportuar atë drejt vendit të përcaktuar, së bashku me ushqimet e marra me vete. Znj. Xh. K. theksoi faktin që kishte qenë e pranishme dhe kishte vënë re se mimika e taksistit reflektoi pakënaqësi në momentin e ofrimit të shërbimit taksi ndaj personit transgjinator, por megjithatë e kreu shërbimin duke e dërguar personin në adresën e caktuar. Në vijim, kur nga përfaqësuesit e shoqatës Aleanca LGBTI është kërkuar me telefon, në të njëjtën ditë, shërbimi i rradhës nga kjo shoqëri, kjo e fundit nuk e ka ofruar atë dhe sipas versionit audio të bisedës së regjistruar me operatoren e shërbimit të kësaj shoqërie rezultoi se taksistët e punësuar nga kjo shoqëri nuk ishin dakord t’u ofronin shërbimin taksi individëve transgjinatorë. Përfaqësuesit e Shoqatës Aleanca LGBTI vunë theksin në faktin se falja publike e Green Taxi nuk reflektonte pendesë reale dhe nuk konsistonte në marrjen e masave përkatëse, efektive, që një veprim i tillë të mos përsëritej më në të ardhmen. Përfaqësuesit e kësaj shoqate e vunë theksin në faktin se shoqëria “Green Taxi” nuk kishte manifestuar me flamurët e komunitetit LGBTI, në datën 17.05.2021, sikurse ishte shprehur në deklaratën e faljes publike, të publikuar në www.dylbersizem.com dhe në www.historiaime.al, si dhe nuk kishte reaguar me përgjigje ndaj e-mailit të dërguar nga ana e znj. Xh. K., për dhënien e trajnimeve falas për stafin e kësaj shoqërie.

Ndërkohë që, përfaqësuesja e Shoqërisë “Green Taxi” u shpreh se kjo shoqëri nuk bënte dallim ndërmjet klientëve dhe shërbimin taksi e ofronte ndaj të gjithëve, pavarësisht orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Shoqëria “Green Taxi” theksoi faktin se qëndrimi i punonjësve të involvuar në këtë çështje, nuk ishte qëndrimi zyrtar i kësaj kompanie. Kjo shoqëri kishte marrë masa disiplinore ndaj këtyre punonjësve. Versioni i parashtruar i çështjes nga përfaqësuesja e kësaj shoqërie konsistonte në faktin se ndërmjet taksistit dhe individit transgjinator kishte patur fyerje reciproke, të cilat ishin iniciuar nga ana e klientit e ishin vijuar nga taksisti. Për këtë veprim të taksistit, shoqëria kishte marrë masë disiplinore ndaj tij. E pyetur nëse në datën 17 maj 2021, taksitë e kësaj shoqërie kishin manifestuar me flamurët e komunitetit LGBTI, sikurse ishte premtuar në deklaratën e faljes publike, përfaqësuesja e kësaj shoqërie u shpreh se një gjë e tillë ishte kryer, por nuk dispononte prova për të vërtetuar një gjë të tillë. Përfaqësuesit e shoqatës Aleanca LGBTI e mohuan dhe kundërshtuan këtë

thënie, duke theksuar faktin se nëse do të ishte kryer një veprim i tillë nga subjekti, një gjë e tillë do të ishte reflektuar në foto apo video.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes ex-officio, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma c), të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;”, Komisioneri filloi shqyrtimin kryesisht të çështjes, lidhur me refuzimin e shërbimit taksi, në datën 26.03.2021, individëve transgjnorë, nga ana e shoqërisë “Green Taxi”. Informacioni i besueshëm për shkelje të LMD, të ndryshuar, u depozitua pranë Komisionerit, nga Shoqatat Aleanca LGBTI dhe Pro LGBT Albania.

Referuar versionit të ngjarjes së ndodhur në datën 26.03.2021, të parashtruar nga ana e përfaqësuesve të shoqatës Aleanca LGBTI, si dhe mbështetur në audion e bisedës së regjistruar me operatoren e shoqërisë “Green Taxi”, rezulton se kjo e fundit është shprehur se shoferët nuk pranojnë t’i ofrojnë shërbimin taksi, personave transgjnorë (travestitë). Pretendimi i shoqatës Aleanca LGBTI konsiston në refuzimin e një shërbimi publik ndaj personave transgjnorë, duke vënë në dukje faktin se shërbimi është refuzuar në kërkesën e tyre, të dytë. Përfaqësuesja e shoqërisë “Green Taxi”, në seancën dëgjimore, të datës 24.06.2021, ka parashtruar një version tjetër të ngjarjes së ndodhur, duke sqaruar se ndërmjet shoferit dhe individit transgjnor ka patur një konflikt verbal, i cili është iniciuar nga klienti e është vijuar nga taksisti i punësuar nga shoqëria “Green Taxi”. Në këtë kontekst, Green Taxi është shprehur se ka ndërmarrë masa disiplinore ndaj personave përgjegjës, masa këto që nuk janë depozituar asnjëherë në cilësi prove pranë KMD-së. Njëkohësisht, Komisioneri ka konstatuar se Green Taxi nuk e ka vërtetuar në asnjë rast versionin e saj të ngjarjes me fakte dhe prova konkrete, sikurse është vepruar nga ana e shoqatës Aleanca LGBTI, e cila në cilësinë e informacionit të besueshëm, të dërguar në adresë të KMD-së, ka përcjellë linkun, ku ndodhet e publikuar biseda e regjistruar me operatoren e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër, shoqëria “Green Taxi” ka theksuar faktin se qëndrimi i këtyre punonjësve nuk është qëndrimi zyrtar i shoqërisë, si dhe ka kërkuar falje publike në www.dylbersizem.com dhe në www.historiaime.al, lidhur me sa ka ndodhur. Në pretendimet e saj, Shoqëria Green Taxi ka

theksuar faktin se shërbimi i saj publik ofrohet ndaj të gjithë klientëve, pa asnjë dallim, ndërkohë që përmbajtja e bisedës së regjistruar me operatoren e kësaj shoqërie vërteton të kundërtën. Sikurse rezulton edhe nga provat e administruara, taksistët e shoqërisë refuzonin t'u ofronin shërbim individëve transgjnorë.

Për sa më sipër, identiteti gjnor është një nga aspektet themelore të jetës. Seksi i një personi përcaktohet zakonisht menjëherë pas lindjes dhe më pas shndërrohet në një fakt shoqëror dhe ligjor. Megjithatë, për një numër relativisht të vogël njerëzish, qenia anëtarë të seksit të përcaktuar pas lindjes përbën një problem. Për individë të tjerë lindin probleme për shkak se perceptimi, që ata kanë për vetveten nuk përputhet me seksin e përcaktuar pas lindjes. Këta individë quhen “transgjnorë” ose “transeksualë”.⁵ Nocioni i “identitetit gjnor” na jep mundësinë për të kuptuar, se seksi i përcaktuar pas lindjes mund të mos përputhet me identitetin gjnor, që zhvillon fëmija, kur ai ose ajo rritet. “Identiteti gjnor” i referohet përjetimit të thellë, të përbrendshëm të gjinisë, që ka çdo person dhe që mund të mos përputhet me seksin e përcaktuar pas lindjes, dhe përfshin përjetimin tejet personal të trupit dhe pasqyrimet e tjera të gjinisë si: veshja, ligjërimi dhe sjellja.⁶ Si nocioni i identitetit gjnor, ashtu edhe format e shprehjes së tij, që përdoren në jetën e përditshme përbëjnë elementë të rëndësishëm, për të kuptuar problemet e të drejtave të njeriut me të cilat përballen njerëzit transgjnorë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, Komisioneri gjykon se çështja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për këtë kategori individësh është më serioze, sesa duket në pamje të parë. Sfida e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për të gjithë nënkupton zbatimin e një qasje të qëndrueshme që nuk përjashton asnjë grup apo kategori njerëzish. Është e qartë se shumë persona transgjnorë nuk i gëzojnë të drejtat e tyre themelore në nivelin e duhur. Kësisoj lind domosdoshmëria për ta parë më nga afër situatën e tyre. Prej kohësh, gjendja e të drejtave të njeriut për individët transgjnorë injorohet dhe lihet pas dore, ndonëse problemet me të cilat ata përballen janë serioze dhe shpesh herë të veçanta për këtë grup. Diskriminimi dhe intoleranca, që përjetojnë individët transgjnorë janë evidente në fushën e shërbimeve.

Referuar Raportit të PNUD⁷ për vitin 2017 rezulton se në Shqipëri stereotipat gjnorë dhe praktikat tradicionale nuk i pranojnë pamjet dhe sjelljet që nuk përputhen me gjininë. Madje edhe vetë brenda modelit gjnor binar, stereotipat janë tejet të ngurtë dhe imponojnë sjellje rreptësisht të përcaktuara mashkullore ose femërore, dhe sjellja e njerëzve duhet t'i përmbahet

⁵ Referuar citimeve të botimit “*Human Rights and Gender Identity*”, (2009), Office of the Commissioner for Human Rights, Council of Europe;

⁶ Referuar përcaktimit tek *Yogyakarta Principles on the Application of International Human Rights Law in relation to Sexual Orientation and Gender Identity*;

⁷ PNUD (2017) Të jesh LGBTI në Evropën Lindore: Raport për Shqipërinë, f. 41 – 46;

njërës ose tjetrës kategori gjinore përkatëse. Devijimet midis dy skajeve të sistemit gjinor binar dekurajohen me forcë dhe quhen të dënueshme nga pikëpamja morale. Si një shoqëri kryesisht patriarkale, shqiptarët tregojnë mosmiratim të fortë shoqëror për çdo formë seksualiteti që del jashtë normativës heteroseksuale. Vrojtmet studimore për homofobinë kanë treguar se shqiptarët kanë perceptime shumë negative për personat LGBTI. Personat transgjnorë përballen me një intensitet kritik dhune, për shkak të pamjes së tyre të jashtme që nuk përputhet me modelet e përcaktuara gjinore. Raporti për shkëljen e të drejtave të njeriut evidenton një diskriminim të theksuar të personave transgjnorë në shkolla, bare dhe rrugë.

Për mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit të personave transgjnorë është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020⁸, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 390, datë 25.05.2016 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 03.02.2016 “*Për Miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale, 2016-2020*”. Qëllimet strategjike dhe 14 objektivat specifike të PKV 2016-2020 u mbështetën në nevojat e adresuara nga vetë komuniteti LGBTI. PKV 2016-2020 përmbante tre qëllime strategjike që lidhen me: (1) Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe me ndërgjegjësimin për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI në përputhje me standardet ndërkombëtare; (2) Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI; (3) Përmirësimin e aksesit në shërbimet e punësimit, arsimit, shëndetësisë, strehimit dhe sporteve për personat LGBTI, të cilëve duhet t’u garantohet mundësia për të drejta të barabarta. Ky PKV adresoi problematikat dhe çështjet që ndikonin në jetën e personave LGBTI duke krijuar pabarazi dhe diskriminim dhe ishte në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.

Referuar Raporti i Vlerësimit i PKV 2016-2020 rezulton se mbështetur në anketimet e realizuara, të anketuarit raportojnë nivele të larta formash të ndryshme diskriminimi. Nga një analizë e thjeshtë e të dhënave të këtij pyetësi, situata është shqetësuese, ku, pothuajse 98% e të anketuarve raportojnë ofendime, tallje dhe poshtërim të vazhdueshëm për shkak të statusit të tyre LGBTI. 43.7% pretendojnë se kanë qenë objekt talljesh nga rrethet e ngushta sociale, kurse pjesa tjetër raportojnë konfrontime të vazhdueshme me situata diskriminuese, si shmangia publike, trajtimi i pabarabartë dhe thashethemet dashakeqe. Të pyetur për vendin/ambientet ku kanë ndodhur këto incidente, 46.4% e të anketuarve u shprehën se kanë qenë viktimat të diskriminimit në shkolla ose universitete. Mes vendeve të tjera ku kanë ndodhur këto incidente, 29.5% e anëtarëve të komunitetit raportojnë situata diskriminuese në familje, 21.7% raportojnë diskriminim nga të afërmit, rreth 32% raportojnë diskriminim në rrjetet dixhitale, 18.3%

⁸ Plani i ri i veprimit 2021 – 2025, për LGBTI është duke u hartuar në bashkëpunim me të gjithë partnerët dhe institucionet përgjegjëse.

raportojnë diskriminim në lagjet ku jetojnë dhe rreth 15% raportojnë incidente lidhur me diskriminimin në vende të tjera publike, bare, pub-e dhe restorante. Situata diskriminuese raportohen edhe në ambientet e zyrave shtetërore dhe në institucione të ofrimit të shërbimeve.

Për sa më sipër, rezulton se diskriminimi dhe intoleranca, që përjetojnë individët transgjnorë janë evidente në fushën e shërbimeve, kujdesit shëndetësor, punësimit etj. Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se nëse klientët nuk do të ishin transgjnorë, shërbimi taksi do t'u ishte ofruar normalisht, pa asnjë hezitim, nga ana e taksistëve të Green Taxi.

Mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesisht të kësaj çështjeje, Komisioneri gjykon se ngjarja në fjalë konsiston në refuzimin e një shërbimi publik ndaj një personi transgjnor, nga ana e “Green Taxi”, fakt i cili bie ndesh me parashkrimin e nenit 20, pika 1, të tij ku parashikohet shprehimisht se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se mbështetur në bisedën telefonike të regjistruar, refuzimi i shërbimit ndaj një personi transgjnor, nënkupton se ky refuzim i adresohet çdo personi që i përket këtij komuniteti. Në këtë mënyrë, shoqëria “Green Taxi” e ka ekspozuar këtë komunitet ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, me individët e tjerë, të cilëve ofrohet shërbimi publik taksi.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në këtë çështje të hetuar kryesisht, Komisioneri po shqyrton ngjarjen e ndodhur në datën 26.03.2021, në lidhje me refuzimin e shërbimit taksi ndaj disa personave transgjnorë, nga ana e Shoqërisë “Green Taxi”. “Identiteti gjnor” është një shkak diskriminimi, i lidhur ngushtë me shkakun e “orientimit seksual”. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se për efekt të shqyrtimit të kësaj çështjeje, këto shkaqe do të trajtohen së bashku.

“Identiteti gjnor” dhe “Orientimi seksual” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjnor, orientimin

seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në lidhje me çështjen nën shqyrtim, Komisioneri gjykon se, këto shkaqe janë të mbrojtura ligjërisht, pasi parashikohen si të tillë nga ligji i sipërcituar, si dhe të gjithë personat në fjalë e mbartin këtë shkak⁹.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Në çështjen e iniciuar dhe hetuar kryesisht nga KMD, në bazë të informacionit të besueshëm të përcjellë nga Shoqatat Aleanca LGBTI dhe Pro LGBT Albania, rezultoi se komuniteti transgjinnor është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë nga ana e shoqërisë “Green Taxi”, si pasojë e refuzimit të shërbimit taksi ndaj përfaqësuesve të këtij komuniteti.

Për sa më sipër, legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar i ofrojnë mbrojtje të posaçme nga diskriminimi, për shkak të identitetit gjinnor dhe orientimit seksual, ndaj individëve LGBTI.

E drejta e çdo individi për barazi para ligjit është universale, siç përcaktohet shprehimisht nga neni 1, i *Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut* së vitit 1948, ku parashikohet: *“Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta”*. Në këtë aspekt, mbrojtja e individëve nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinnor nuk duhet të nënkuptojë krijimin e të drejtave të reja, ose të veçanta për personat LGBTI, por thjesht, shtrirjen e të drejtave të njëjta për këta individë, sikurse ato që gëzojnë të gjithë individët e tjerë në bazë të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në Paktin e OKB-së mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, Komiteti i OKB-së mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore ka konstatuar se *“identiteti gjinnor njihet si një nga shkaqet e mbrojtura të diskriminimit”*.

Në Deklaratën e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut gjatë Konferencës Ndërkombëtare *“Mbi të drejtat e njeriut të personave LGBT”*, në Montreal, në 26

⁹ Referuar bisedës së regjistruar telefonike ndërmjet përfaqësuesve të shoqatës Aleanca LGBTI dhe operatores së shoqërisë Green Taxi, punonjësja u referohet personave transgjinnorë si travestitë.

qershor 2006, u vu theksi tek njohja e identitetit gjinor dhe orientimit seksual si shkaqet kryesore të diskriminimit të këtij komuniteti.¹⁰ Në këtë Deklaratë, u vu theksi tek detyrimi i shteteve për të mos heshtur para diskriminimit të këtij komuniteti për shkaqet e sipërcituara.

Në nenin 14, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) parashikohet shprehimisht se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Neni 1¹¹, i Protokollit 12, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të këtij neni, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) i autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njej individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik.

Në parim, instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbrojnë çdokënd nga diskriminimi. Ndonëse “identiteti gjinor” së bashku me “orientimin seksual” shpesh herë nuk përmenden në traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si shkaqe diskriminimi, këto traktate i përfshijnë automatikisht këto shkaqe, falë klauzolave të tyre të hapura.

Sikurse vihet re sa më sipër, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk përmendet shprehimisht *“orientimi seksual”* ose *“identiteti gjinor”*, në listën e shkaqeve të diskriminimit të parashikuar nga Neni 14 i KEDNJ-së dhe Protokollit i saj nr. 12 (ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit). Megjithatë kjo listë është e hapur dhe nuk ka asgjë që pengon në praktikë përfshirjen e diskriminimit për shkaqet e orientimit seksual ose identitetit gjinor ndërmjet shkaqeve të mbrojtura.

¹⁰ www.unhchr.ch/hurricane/hurricane.nsf/0/B91AE52651D33F0DC12571be002F172C?opendocument.

¹¹ Neni 1, protokollit 12, i KEDNJ parashikon shprehimisht: *“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar se Neni 14, i KEDNJ-së mbulon orientimin seksual¹² dhe Raporti Shpjegues për Protokollin nr. 12, dëshmon se ky instrument ofron mbrojtje kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual. E njëjta gjë nënkuptohet në mënyrë të arsyeshme edhe për identitetin gjinor, i cili duhet të mbulohej ligjërisht si nga Neni 14 dhe nga Protokollin nr. 12, i KEDNJ.

Në çështjet *Salgueiro da Silva Moutak kundër Portugalisë*, 21 dhjetor 2001 dhe *Karner kundër Austrisë*, 24 korrik 2003, GJEDNJ është shprehur se: “.....për qëllim të Nenit 14, dallimi në trajtim është diskriminues, nëse ai nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm, pra nëse ai nuk bëhet për shkaqe legjitime, ose në rast se nuk ekziston një marrëdhënie legjitime, ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme përpjestueshmërie ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.¹³ Gjykata ka konstatuar më tej se shteteve u njihet një kufi i ngushtë vlerësimi në raste të tilla, pasi ata prekin një nga çështjet më intime të jetës private dhe, si rezultat, duhet të ekzistojnë shkaqe serioze për të justifikuar ndërhyrjen nga organet publike. Testi i përpjestueshmërisë nuk kërkon vetëm që një ndërhyrje e tillë në parim të jetë e përshtatshme për realizimin e qëllimit të kërkuar, por edhe që të dëshmohet se ajo është e nevojshme për të arritur qëllimin”.¹⁴

Në çështjen *Sheffield and Horsham v. the United Kingdom*¹⁵, (1999), GJEDNJ shprehet se: “Gjykata përsërit se neni 14 ofron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga dispozitat e tjera thelbësore të Konventës. Sidoqoftë, jo çdo ndryshim në trajtim do të përbëjë shkelje të këtij neni. Në vend të kësaj, duhet të përcaktohet që personat e tjerë në një situatë analoge ose përkatësisht të ngjashme gëzojnë trajtim preferencial dhe se nuk ka asnjë justifikim të arsyeshëm ose objektiv për këtë dallim.”

Citimi i sipërpërmendur përforcohet edhe në çështjen *L. dhe V. kundër Austrisë*, 9 janar 2003,¹⁶ ku citohet: “Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një ndryshim në trajtim është diskriminues për qëllimet e nenit 14 nëse “nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”, do të thotë nëse nuk ndjek një “qëllim legjitim” ose nëse nuk ekziston një “marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet”.

¹²Shih, *inter alia*, *Salgueiro da Silva Moutak kundër Portugalisë*, 21 dhjetor 2001 dhe *Karner kundër Austrisë*, 24 korrik 2003.

¹³ Shih *Karner k. Austrisë* (2003), paragrafi 37;

¹⁴ Shih *Karner k. Austrisë* (2003), paragrafi 41;

¹⁵ Case of *Sheffield and Horsham v. the United Kingdom* (31–32/1997/815–816/1018–1019)

¹⁶ Shih çështjen *L. dhe V. kundër Austrisë*, 9 janar 2003, nr. 39392/98 dhe 39829/98;

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e vitit 1950 ka luajtur një rol qëndror në mbrojtjen e të drejtave të homoseksualëve dhe transgjinorëve në nivel evropian. Këto të drejta janë identifikuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore, që zbaton KEDNJ. Gjykata ka luajtur një rol thelbësor në këtë fushë duke sjellë risi dhe interpretime të ndryshme në legjislacion, nëpërmjet gjykimit të çështjeve të caktuara në lidhje me orientimin seksual, duke filluar në 1981, dhe identitetin gjinor, duke filluar në 1997.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e çështjes “Féret kundër Belgjikës”, thekson në çështjen “*Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*”¹⁷, se: “*diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të racës, origjinës, ose ngjyrës*”.

GJEDNJ e ka konsideruar orientimin seksual si shkak të lidhur ngushtë me jetën private të individit, e cila në asnjë moment nuk duhet cënuar. Në çështjen *Kozak kundër Polonisë*, 2 Mars 2010, nr. 13102/02, GJEDNJ është shprehur: “*Padyshim, orientimi seksual, një nga pjesët më intime të jetës private të një individi, është i mbrojtur edhe nga neni 8 i Konventës.*”

Në çështjen *Schlumpf kundër Switzerland*, 09.01.2009, GJEDNJ është shprehur: “*Vetë thelbi i Konventës (KEDNJ) është respektimi i dinjitetit njerëzor dhe lirisë së njeriut. Kështu, garantohet e drejta e transeksualëve për zhvillim personal dhe siguri fizike dhe morale*”.

Në çështjen *L. and V. kundër Austrisë*, 9 janar 2003, gjykata shprehet: “*Ashtu si ndryshimet e bazuara në dallimet e gjinisë, edhe ato mbi orientimin seksual kërkojnë arsye serioze si justifikim*”.

Në çështjen *Alekseyev kundër Rusisë*¹⁸, 21 tetor 2010, citohet: “*Aty ku vihet re një ndryshim në trajtim për shkak të gjinisë apo orientimit seksual, marzhi i vlerësimit të shteteve është i ngushtë dhe në situata të tilla parimi i proporcionalitetit nuk kërkon thjesht që masa e zgjedhur të jetë e përshtatshme për realizimin e qëllimit të kërkuar; duhet gjithashtu të tregohet se ishte e nevojshme në rrethanat ekzistuese.*”

Përveç GJEDNJ, edhe gjykatat kombëtare në vende të ndryshme kanë luajtur rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Duke e lidhur me rastin në shqyrtim, këto gjykata, në disa shtete kanë konstatuar diskriminim për shkak të orientimit seksual, si pasojë e mosfrimit të shërbimit të kërkuar nga ana e personave që i përkasin komunitetit LGBTI.

¹⁷ *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012.

¹⁸ *Alekseyev v. Russia*, 21 October 2010, nos. 4916/07, 25924/08 and 14599/09

Kështu, Gjykata e Apelit në Suedi¹⁹ ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë, në rastin kur një personi LGBTI i është refuzuar shërbimi në një dyqan kafshësh, ku ai dëshironte të blinte një këlysh qeni. Refuzimi i shitëses për të mos i shërbyer klientit, bazohet në faktin se blerësi ishte homoseksual.

Në Francë, Gjykata është shprehur për diskriminim për shkak të orientimit seksual, të një gruaje lezbike, pasi i është refuzuar kërkesa për birësim të një fëmije, pasi ajo bashkëjetonte me një grua tjetër²⁰. Ankuesja pretendoi se në çdo fazë të procedurave të ndjekura për të birësuar një fëmijë, ajo kishte vuajtur një trajtim diskriminues që ishte mbështetur në orientimin e saj seksual, duke ndërhyrë njëkohësisht edhe në të drejtën e respektimit të jetës së saj, private. Gjykata vendosi që kishte pasur një shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ. Gjykata franceze doli në përfundimin se homoseksualiteti i kërkueses kishte qenë një faktor përcaktues në refuzimin e kërkesës së saj, në kushtet, kur legjislacioni francez lejon personat beqarë të birësojnë një fëmijë, duke hapur kështu mundësinë e birësimit nga një homoseksual i vetëm.

Vendime të ngjashme janë dhënë edhe për çështje të tilla si: *Gas and Dubois v. France* (15 March 2012) apo *X and Others v. Austria* (no. 19010/07), (19 February 2013 (Grand Chamber)), ku refuzimi i aksesit në fushën e shërbimeve ndaj personave homoseksualë është konsideruar diskriminim i drejtpërdrejtë, që bie ndesh me Nenin 14 të KEDNJ.²¹

Barazia dhe mosdiskriminimi i komunitetit LGBTI ka qenë një përparësi edhe e Bashkimit Evropian që nga viti 2014, kur Parlamenti Evropian lëshoi një Rezolutën “*Udhërrëfyese i BE-së kundër homofobisë dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*” dhe i bën thirrje Komisionit Evropian të zhvillojë “*një politikë shumëvjeçare për të mbrojtur të drejtat themelore të personave LGBTI*”. Pas kësaj Rezolutive, Komisioni Evropian prezantoi në vitin 2015 “*Planin e Veprimit për të çuar përpara barazinë e komunitetit LGBTI*”, që u miratua në vitin 2016 nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian. Në këtë plan veprimi paraqiten masat konkrete që Komisioni u zotua të ndërmarë përgjatë viteve 2015 -2019, për të rritur përpjekjet për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit.

¹⁹Shih Ombudsman Against Discrimination on Grounds of Sexual Orientation v. A.S., Case No. T-3562-06, Svea Court of Appeal, 11 February 2008;

²⁰Shih E.B. v. France (no. 43546/02), 22 January 2008 (Grand Chamber);

²¹ Factsheet “*Sexual orientation issues*” (Feb 2021) – European Court of Human Rights;

Në vitin 2018, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara përsëriti, me rastin e 70 vjetorit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, se “*Kombet e Bashkuara ngrene zërin për të drejtat e komunitetit LGBTI*”.²²

Nëpërmjet Rekomandimit CM / Rec (2010) 5, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës, “*Për vendet anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor*”, u rekomandohet të gjithë shteteve anëtare të garantojnë zbatimin e parimeve dhe masave të parashikuara në Shtojcën e këtij Rekomandimi, në legjislacionin, politikat dhe praktikat kombëtare të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve dhe me rritjen e tolerancës ndaj kësaj kategorie njerëzish. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës rekomandon fuqimisht shtetet anëtare “*për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor*”.

Në Rezolutën 1728/2010 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “*Mbi diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*”²³ u bëhet thirrje vendeve anëtare t’i japin fund “*diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*”.

Nën frymën e akteve të sipërcituara dhe praktikave gjyqësore, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, siguron të drejtën e çdo individi për t’u mbrojtur nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për të gjitha shkaqet e përcaktuara në nenin 1, të këtij ligji. Në nenin 20, pika 1, të LMD, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*I. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*”

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore*

²²<https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2018-09-25/secretary-generals-video-message-ministerial-level-meeting-un-lgbti> (accessed on 25 November 2019).

²³ CoE Parliamentary Assembly (2010), *Resolution 1728 on the Discrimination on the basis of sexual orientation and gender identity*, <http://assembly.coe.int> (accessed on 25 November 2019).

të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “*a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin*”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast shoqërisë “Green Taxi“, që duhet të provojë se individëve transgjinorë, të cilëve u është refuzuar shërbimi taksi, nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, disfavorizuese dhe të pabarabartë, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Kështu, neni 33, pika 7/1 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS²⁴ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër së cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër së cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër së cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që, megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

²⁴ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.²⁵

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të administruara, që rezultuan nga procedura e shqyrtimit të çështjes kryesisht, Komisioneri gjykon se ekziston një trajtim i padrejtë, i disfavorshëm dhe i pabarabartë i individëve transgjjinorë, si pasojë e refuzimit të shërbimit taksi nga ana e shoqërisë “Green Taxi”.

Një fakt i tillë vërtetohet nga regjistrimi audio i bisedës telefonike ndërmjet operatores së shërbimit taksi dhe përfaqësuesve të shoqatës Aleanca LGBTI, fakt ky i pranuar nga ana e shoqërisë “Green Taxi”. Gjatë hetimit administrativ, shoqëria Green Taxi dështoi për të provuar njërin prej momenteve të mëposhtëm:

1. Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkaqeve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë ndaj personave transgjjinorë, të konstatuara edhe nga Komisioneri në këtë vendim ose,
2. Veprimet e kësaj shoqërie kundrejt individëve transgjjinorë, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në referencë të nenit 7, pika 1, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”, Komisioneri gjykon se personat transgjjinorë, të cilëve u është refuzuar shërbimi taksi nga ana e shoqërisë “Green Taxi”, janë diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nga ana e kësaj shoqërie.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, pika 1, gërmat a) dhe b), nenin 32, pika 1, gërma c), si dhe nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

²⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të personave transgjinorë, nga ana e shoqërisë “Green Taxi”.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, brenda 3 (tre) muajve nga marrja dijani, Shoqëria “Green Taxi” të bashkëpunojë me organizatat që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për trajnimin e punonjësve të saj, lidhur me çështjet e ndalimit të diskriminimit, në fushën e shërbimeve, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
3. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Komisioneri kërkon nga ana e Shoqërisë “Green Taxi”, mos përsëritjen e situatave të tilla diskriminuese në të ardhmen.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Shoqëria “Green Taxi”, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda 45 ditëve, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Tëmira dhe shërbime
Shkak – orientimi seksual dhe identitetit gjinor
Lloji i vendimit - diskriminim